

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Më parë ndërtohet kapaciteti", zëvendësministria e Mbrojtjes: Shqipëria nuk duhet të blejë vetëm produkte ushtarake, por...
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/13/para-ndertohet-kapaciteti-zevendesministria-e-mbrojtjes-shqiperia-nuk-duhet-te-bleje-vetem-produkte-ushtarake-por/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 15:28:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	13 shtator 2026, 13:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 13 shtator 2026, 12:59:00 UTC → 13 shtator 2026, 13:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f38988323368b1788731e6b592ca4517c892fac4102c4b381bdf19a5fdfa6552
TEKSTI	ffc148e5d416bd4441161f7ef35fda1a4de4868dfb9b9df913d55ff1dbb8c087
PAMJA	3eae10177debe9d08be070ac08e5c4fdd4a979d02897cf8b3e06b13fd6be641b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92c54066a49634db5d7b07ceef6e14aba804355d8ab52cc22a8e9ca3fa5cf65
E MËPARSHMJA	b4e7d30d2d54e445259b6b1463a6dbea2df4a3c9315219803e7726fc139fdb05
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92c54066a49634db5d7b07ceef6e14aba804355d8ab52cc22a8e9ca3fa5cf65>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Lajme](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Pop News](#)
- [Programe](#)
- [Youtube](#)
- [Top News LIVE](#)

Accessibility options



- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Video](#)
- [Programe](#)
- [Lajme](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

Kërko...

[Aktualitet Të Fundit](#)

“Më parë ndërtohet kapaciteti”, zëvendësministria e Mbrojtjes: Shqipëria nuk duhet të blejë vetëm produkte ushtarake, por...

13/09/2026 15:00



Zëvendësministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, ka reaguar lidhur me zhvillimin e industrisë së mbrojtjes në Shqipëri, duke theksuar se rezultatet nuk mund të maten vetëm me produktet që prodhohen në fazat e para të një projekti industrial.

“Industria e mbrojtjes nuk ndërtohet brenda natës. Para produktit ndërtohet kapaciteti”, shprehet Abrazhda, duke argumentuar se fillimisht duhet të ndërtohen infrastruktura, aftësitë njerëzore, teknologjia, proceset industriale dhe kapacitetet e integritimit.

Sipas saj, synimi është që investimet në sektorin e mbrojtjes të shërbejnë edhe për krijimin e kapaciteteve strategjike, teknologjike dhe ekonomike që mbeten në Shqipëri.

Abrazhda thekson se industria moderne e mbrojtjes funksionon përmes zinxhirëve industrialë dhe partneriteteve ndërkombëtare, ku kompani të ndryshme prodhojnë komponentë, nënsisteme apo ofrojnë teknologji dhe know-how, ndërsa integruesi bashkon këto kapacitete në një produkt përfundimtar.

Postimi i plotë:

Industria e mbrojtjes nuk ndërtohet brenda natës. Para produktit ndërtohet kapaciteti!

Nuk mund të kërkojmë produktin sot, kur je ende duke ndërtuar kapacitetin që do ta bëjë të mundur nesër.

Kjo është arsyeja pse një projekt industrial në fazat e tij të para nuk mund të gjykohej vetëm me pyetjen:

“Çfarë ka prodhuar sot?”

Duhet të pyesim edhe:

“Çfarë kapaciteti po ndërton për nesër?”

Vizioni është më i madh se një produkt

Vizioni është të ndërtojmë, hap pas hapi, një gjeneratë të re kapacitetesh kombëtare: të sjellim teknologji dhe know-how, të zhvillojmë njerëzit dhe aftësitë tona, të modernizojmë infrastrukturën, të krijojmë procese industriale, të integrojmë kompani shqiptare në zinxhirë ndërkombëtarë dhe të jemi në gjendje të krijojmë gjithnjë e më shumë vlerë industriale në Shqipëri.

Është ta transformojmë një pjesë të shpenzimit të nevojshëm për mbrojtjen në kapacitet strategjik, teknologjik, njerëzor dhe ekonomik që mbetet në vend.

Këtu duhet kuptuar edhe dallimi mes asaj që thashë në intervistë dhe asaj që Ministri [Ermal Nufi](#) thotë.

Në intervistën time fola për atë që ekziston sot. Ministri po flet për vizionin, për projektet dhe kapacitetet që po ndërtohen për të ardhmen.

Kjo nuk është në kundërshtim!

www.mirëpresin.com

Njëra është fotografia e sotme. Tjetra është rruga industriale drejt së nesërme. Industria e mbrojtjes nuk funksionon si industria e mallrave të konsumit

Ky është një dallim shumë i rëndësishëm për të kuptuar të gjithë debatin.

Një produkt kompleks i mbrojtjes nuk është një produkt i zakonshëm konsumi, ku imagjinojmë një fabrikë, një linjë prodhimi dhe një produkt që prodhohet nga fillimi në fund në të njëjtin vend.

Industria moderne e mbrojtjes është industri sistemesh, zinxhirësh industrialë dhe integrimi.

Atëherë, a ka në botë prodhues të mbrojtjes apo integrorë?

Ka të dyja. Dhe pikërisht ky është thelbi.

Ekzistojnë prodhues komponentësh, prodhues nënsistemesh, kompani teknologjike, furnitorë të specializuar dhe kompani që marrin rolin e prime contractor ose system integrator.

Edhe NATO e përshkruan bazën industriale të mbrojtjes në këtë mënyrë: nga prime contractors te kompanitë e mesme e të vogla, start-ups dhe prodhuesit e nënsistemeve dhe komponentëve përgjatë zinxhirëve të furnizimit.

Një kompani prodhon një komponent. Një tjetër një nënsistem. Një tjetër sjell teknologjinë apo know-how. Të tjera ofrojnë software, elektronikë, materiale apo shërbime inxhinierike.

Në fund, të gjitha këto duhet të funksionojnë së bashku si një sistem i vetëm.

Dhe këtu qëndron roli i integrorit.

Vlera e integrorit nuk është domosdoshmërisht të prodhojë vetë çdo pjesë. Vlera është aftësia për të bashkuar teknologjitë, komponentët dhe nënsistemet e ndryshme në një kapacitet përfundimtar të integruar, të testuar dhe të standardizuar.

Përdoruesi ushtarak nuk kërkon një koleksion komponentësh të shkëputur. Kërkon një kapacitet të integruar që përbush kërkesën e përcaktuar operacionale sepse kapaciteti operacional nuk krijohet nga komponentët të shkëputur. Krijohet nga sisteme që funksionojnë së bashku.

Prandaj, kur flasim për “prodhim” në këtë industri, pyetja nuk mund të jetë vetëm:

“Sa pjesë prodhojmë vetë?”

Duhet të jetë edhe:

“Sa aftësi kemi për të integruar, mirëmbajtur dhe mbështetur një kapacitet dhe sa nga kjo vlerë mbetet në Shqipëri?”

Industria moderne nuk funksionon është izolim. Është specializim, partneritet dhe integrim.

Shqipëria ka pasur industri. Por modeli ka ndryshuar. Ato kapacitete u krijuan në një sistem ekonomik, teknologjik dhe strategjik krejt tjetër.

Në një ekonomi të centralizuar, shteti mund të zotëronte fabrikën, të përcaktonte prodhimin, ta financonte dhe të kontrollonte pothuajse të gjithë zinxhirin. Sot Shqipëria është ekonomi tregu dhe vend anëtar i NATO-s. Teknologjia ka ndryshuar. Standardet kanë ndryshuar. Zinxhiritë industriale janë ndërkombëtare.

Prandaj nuk po rindërtojmë industrinë e së kaluarës. Po transformojmë bazën që kemi dhe po ndërtojmë industrinë që i duhet Shqipërisë së dekadave të ardhshme.

Dhe pikërisht për këtë duhen partnerët

Shteti ka dhe duhet të ketë një rol të fortë në një sektor strategjik. Ai përcakton interesin kombëtar, nevojat, standardet dhe rregullat.

Por teknologjia, pronësia intelektuale dhe know-how nuk krijohen me dekrete qeverie!

Nëse një vend nuk zotëron sot një teknologji apo aftësi industriale, mund të investojë kohë, njerëz dhe kapital për ta zhvilluar, ose mund të bashkëpunojë me industri që e kanë zhvilluar tashmë. Për një vend të përmasave të Shqipërisë nuk ka kuptim ekonomik të pretendojmë se duhet të zhvillojmë nga zero çdo teknologji dhe çdo komponent.

Partneri i huaj nuk vjen për të zëvendësuar kapacitetin shqiptar. Ai sjell teknologji, eksperiencë, know-how, procese, standarde dhe akses në zinxhirë industrialë më të mëdhenj.

Nëse Shqipëria duhet gjithsesi të investojë për kapacitetet e saj, pyetja nuk duhet të jetë vetëm:

“Çfarë po blejmë?”

Por:

“Çfarë mbetet në Shqipëri?”

A trajnohen njerëzit tanë?

A fitojmë know-how?

A modernizohet infrastruktura?

A krijohen procese industriale?

A zhvillohen aftësi integrimi, mirëmbajtjeje dhe mbështetjeje?

A hyjnë kompani shqiptare në zinxhirë ndërkombëtarë?

A krijohen vende pune dhe aktivitet ekonomik?

Kjo është vlera e shtuar në vend.

Dhe kjo logjikë nuk është një shpikje shqiptare. Në industrinë ndërkombëtare të mbrojtjes ajo zbatohet prej dekadash përmes formave të ndryshme të offset-it dhe industrial participation.

Sipas Departamentit Amerikan të Tregtisë, mbi 80 vende kanë kërkesa për offset.

Format ndryshojnë nga një vend të tjetri. Ato mund të përfshijnë investime, joint ventures, përmbytje lokale dhe forma të tjera të pjesëmarrjes industriale. Por parimi ekonomik është i njëjtë:

Nëse duhet gjithsesi të investosh, syno që sa më shumë nga ai investim të ndërtojë edhe kapacitet në vend. Nëse blejmë vetëm produktin përfundimtar, kemi realizuar një transaksion.

Nëse i njëjti investim na lë edhe njerëzit, dijen, infrastrukturën dhe kapacitetin industrial, kemi ndërtuar diçka që vazhdon të ketë vlerë edhe pas përfundimit të blerjes. Një kapacitet kompleks nuk blihet një ditë dhe harrohet. Ai kërkon mbështetje, mirëmbajtje dhe zhvillim gjatë viteve.

Sa më shumë nga kjo aftësi të ndërtojë në Shqipëri, aq më shumë vlerë, dije dhe kapacitet mbetet këtu.

Fincantieri është shembulli më i thjeshtë

Marrim Pashalimanin.

Shqipëria mund të kishte zgjedhur modelin më të thjeshtë: porosit jashtë, produkti ndërtohet jashtë, paguan dhe e merr.

Nevoja plotësohet.

Por në këtë model, një pjesë shumë e madhe e mundësisë për të krijuar vlerë industriale, dije dhe kapacitet mbetet jashtë Shqipërisë.

Modeli me Fincantieri nis nga një pyetje tjetër:

Nëse Shqipëria duhet gjithsesi të investojë për kapacitetet e saj detare, pse të mos përdoret ky investim edhe për të ndërtuar kapacitet industrial në Shqipëri?

Fincantieri Albania është investimi më i madh industrial në 36 vitet e demokracisë (51% Fincantieri dhe 49% KAYO) dhe partneriteti është ngritur për zhvillimin e kapaciteteve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes detare në Shqipëri, modernizimin e Pashalimanit dhe krijimin e mundësive edhe në tregjet ndërkombëtare.

Dhe këtu kemi një shembull konkret të asaj që shpjegova më lart për integrimin.

Në tregun shqiptar, Fincantieri Albania do të veprojë si prime contractor, me përgjegjësi për ekzekutimin dhe menaxhimin e furnizimit. Produktin, Patentën, Dijen Operacionale, Klientët e huaj dhe Kredibilitetin i sjell të gjitha Fincantieri, jo KAYO!

Por duhet kuptuar rendi i gjërave.

Nuk mund të kërkojmë sot produktin përfundimtar nga një kantier që ende po modernizohet për të krijuar kapacitetin që do ta bëjë atë të mundur.

Kjo nuk është dështim; Është rendi normal i zhvillimit industrial.

Së pari duhet infrastruktura.

Duhen njerëzit.

Duhen trajnim.

Duhet teknologjia dhe know-how.

Duhen proceset dhe standardet.

Duhet integrimi me zinxhirin industrial të partnerit.

Pastaj vjen produkti.

Dhe pikërisht këtu kuptohet pse duhet një partner si Fincantieri.

Shqipëria zotëron sot të gjithë teknologjinë, eksperiencën, proceset dhe rrjetin industrial që pikërisht po përpiqet të ndërtojë.

Partneriteti ekziston për të shkurtuar atë distancë.

Kjo shoqërohet edhe me zhvillimin e aftësive profesionale lokale: bashkëpunimi mes Fincantieri, KAYO dhe Institutit Profesional “Pavarësia” në Vlorë parashikon trajnim, praktika dhe zhvillim kompetencash për kapacitetin e ardhshëm industrial të Pashalimanit.

Dhe modeli nuk synon vetëm nevojat shqiptare.

Synimi është që Pashalimani të lidhet edhe me rrjetin ndërkombëtar të partnerit dhe të prodhojë për tregjet ndërkombëtare të mund të krijojë vlerë në Shqipëri.

Kjo është shumë më tepër sesa blerja e një produkti. Është ndërtimi i një aftësie.

Dhe prandaj, kur dikush pyet:

“Ku është produkti?”

përgjigjja duhet të fillojë me një pyetje më themelore:

“A kemi ndërtuar kapacitetin që duhet ta bëjë atë të mundur?”

Sepse nuk ndërton dot produktin përpara se të kesh njerëzit, dijen, teknologjinë, proceset dhe infrastrukturën që duhen për ta realizuar.

Dhe nuk është e nevojshme që çdo pjesë e tij të prodhohet në Shqipëri që Shqipëria të ketë industri.

Industria moderne është një zinxhir. Vlera jonë është sa aftësi ndërtojmë brenda atij zinxhiri dhe sa prej saj mbetet në Shqipëri.

Ky është vizioni:

Të blesh një produkt është një transaksion.

Të ndërtosh njerëzit, dijen, infrastrukturën, integrimin dhe aftësinë për ta mbështetur është industri.

Dhe, vit pas viti, objektivi duhet të jetë i qartë:

Të dimë të bëjmë më shumë këtu.

Të integrojmë më shumë këtu.

Të mirëmbajmë më shumë këtu.

Të trajnojmë më shumë njerëz këtu.

Të krijojmë më shumë vlerë në Shqipëri.

Industria e mbrojtjes nuk ndërtohet brenda natës. Para produktit ndërtohet kapaciteti.

Top Channel

[Aktualitet »](#)



[Rama paralajmëron hapjen e 4 universiteteve të reja në vend, kryeministri zbulon qytetet që do të mirëpresin institucionet arsimore](#)

13/09 17:56



Angli/ Dënohet agjenti imobilar, i siguroi shqiptarëve 19 shtëpi për të mbjellë kanabis me vlerë dy milionë sterlina
13/09 15:55

AKU “i shpëton” mishit me antibiotik/ Dy ngarkesa me mish pule të rrezikshëm nga Brazili, njëra prej tyre u konsumua
13/09 15:43

Zbulohet pse “Çunat e Londrës” po stepen në të investuarin në Shqipëri, Daily Mail gjurmon pronat e konfiskuara
13/09 15:15

“300 mijë euro vendosi të depozita e gazit”/ Zbulohen detaje nga ngjarja e rëndë në Vorë, 56-vjeçari i la kushëririt plumbin në zarf në derën e shtëpisë
13/09 15:11

“Ende nuk e kam humbur shpresën”/ EuReporter artikull për kryebashkiakun Veliaj
13/09 15:10

Na ndiqni:

Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel

Video »

Top News- Sherr me thika në Athinë, plagoset një person, arrestohet shqiptari

Top Channel/ Debatimi me Ramën për ‘Territorialen’, aktorja tregon përballjen me kryeministrin

Top News- ‘300 mijë euro ose të pret vdekja’/ Kanosi kushëririn me letër, prangoset 56-vjeçari

Top News- ‘Si të vrasësh shokët e shkollës’, adoleshenti pyet ChatGPT... alarmohet FBI

Top News – EuReporter artikull për Veliajn/ Kryebashkiaku: Ende nuk e kam humbur shpresën

Top News- Parandalohet vrasja në Rrogozhinë! 26-vjeçari me kallash shkoi te banesa e një gruaje...

Kryesore

“Ende nuk e kam humbur shpresën”/ EuReporter artikull për kryebashkiakun Veliaj

15:10

“Vetë Zot, vetë shkop”/ Pagat e magistratëve, Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën, askush nuk mund të kërcënojë askënd

11:31

Ekskluzive/ Makina Benz e papaguar në 2017-ën prangos shkodranin në Angli, nis procesi i ekstradimit

12:22

Alarm në Lituani/ Mbyllet aeroporti i Vilniusit pas raportimeve për dron, rezultoi se ishin vetëm... zogj

14:38

Ekskluzive/ “S’kam gjë nga zemra, por...”, rrëfimi shokues i Lorenc Trashit pas tmerrit në fushë

14:50

Më të lexuarat

“Dil jashtë”/ Debatimi me Ramën gjatë dëgjësës për ‘Territorialen’ në Berat, Eglja Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe...

Takimi i Ramës në Berat për Territorialen/ Debatimi në sallë mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe Eglja Cenos

“300 mijë euro vendosi të depozita e gazit”/ Zbulohen detaje nga ngjarja e rëndë në Vorë, 56-vjeçari i la kushëririt plumbin në zarf në derën e shtëpisë

Trump zhgënjën Arabinë Saudite, Princi Bin Salman i telefonoi dy herë, por SHBA refuzoi të qëllonte rebelët Houthi

Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, reagon sërish Rama: Gjykatësi fillestar në Shqipëri merr 500 euro më shumë se kolegët në Greqi

Zbulohet pse “Çunat e Londrës” po stepen në të investuarin në Shqipëri, Daily Mail gjurmon pronat e konfiskuara

“Ky nuk është më futboll”, Ronaldo shpërthen ndaj tifozëve të Al-Taawoun: Të ndalohen përgjithmonë nga stadiumet

Angli/ Dënohet agjenti imobilar, i siguroi shqiptarëve 19 shtëpi për të mbjellë kanabis me vlerë dy milionë sterlina

Frikë për djalin e Paolo Maldinit, përfshihet në një aksident me makinë pak orë pasi shënoi golin e fitores në Serie A

Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Artion Zekajt

- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)
- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.